



Nr. 02 prot.

Tiranë, më 04/05/2020

VENDIM

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, date 14.01.2020, "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë" ndryshuar në urdhërin Nr. 99 dt. 26.03.2020 dhe Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", miratuar me vendim të Senatit Akademik, nr. 19, dt. 10.02.2020, Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Artit Skenik në mbledhjen e datës 04.05.2020,

VENDOSI:

1. Përcaktimin dhe miratimin e formularit për regjistrimin e kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore dhe për Drejtues të Njesisë Bazë. Bashkëlidhur vendimit, formulari i aplikimit.
2. Caktimi i datës për fillimin e regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore dhe për Drejtues të Njesisë Bazë. Regjistrimi fillon nga data 05. 05. 2020 deri në datën 09. 05. 2020. Regjistrimi kryhet pranë sekretarisë së KZF nga ora 09:00 deri në orën 16:00.

KRYETAR

Ervin Meniko

ANËTAR

Elis Mataj

ANËTAR

Mauro Zaçe

SEKRETAR

Inis Gjoni



**KËRKESË PËR KANDIDIM
PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE**

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më __/__/__, në _____, të rrethit _____, gjinia _____, paraqes kërkesën time për të kandiduar për Drejtues të Njesisë Kryesore në zgjedhjet e përgjithshme të datës 12.06.2020.

Në përputhje me rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", miratuar me vendim të Senatit Akademik, nr. 19, dt.10.02.2020, nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se:

- a. kam përvojë në mësimdhënie, në krijimtari artistike/kërkim shkencor më shumë se 10 (dhjetë) vjet;
- b. kam përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, kam zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, kam përgatitur literaturë mbështetëse dhe kam zhvilluar projekte kërkimore etj., prej më shumë se 5 (pesë) vjetësh;
- c. nuk jam në ndjekje penale dhe nuk më është dhënë asnjë masë e sigurimit personal;
- d. nuk jam dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- e. nuk jam i dënuar më parë për vepra penale;
- f. nuk kam papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 ("Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë") dhe ligjit nr. 138/2015 ("Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike");
- g. nuk kam fituar dy ose më shumë mandate të njëpasnjëshme në postin e Drejtuesit të Njesisë Kryesore sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë";
- h. nuk kam mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015.
- i. nuk kandidoj për autoritete të tjera drejtuese në Universitetin e Arteve.

Kësaj kërkesë i bashkëngjitet:

- kopja e kartës së identitetit/pasaportës;
- kopja e noterizuar e titullit _____ që unë zotëroj;
- vërtetimi i qendrës time të punës;
- formulari i vetëdeklarimit për integritetin e lartë akademik.

Për sa kam deklaruar në këtë kërkesë, mbaj përgjegjësi penale dhe autorizoj organin përkatës të bëjë verifikimet që ai i konsideron të nevojshme.

Aplikuesi/ja _____

U dorëzua më datën __/__/__, në sekretarinë e KZF



**KËRKESË PËR KANDIDIM
PËR DREJTUES TË NJËSISË BAZË**

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më __/__/__, në _____, të rrethit _____, gjinia _____, paraqes kërkesën time për të kandiduar për Drejtues i Njesisë Bazë të _____ në zgjedhjet e përgjithshme të datës 12.06.2020.

Në përputhje me rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", miratuar me vendim të Senatit Akademik, nr. 19, dt, 10.02.2020, nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se:

- a. kam përvojë në mësimdhënie, më shumë se 5 (pesë) vjet dhe jam pjesë e personelit akademik me kohë të plotë.
- b. kam veprimtari të spikatur akademike, artistike, kërkimore dhe shkencore të vazhdueshme;
- c. nuk jam në ndjekje penale dhe nuk më është dhënë asnjë masë e sigurimit personal;
- d. nuk jam dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- e. nuk jam i dënuar më parë për vepra penale;
- f. nuk kam papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 ("Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë") dhe ligjit nr. 138/2015 ("Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike");
- g. nuk kam fituar dy ose më shumë mandate të njëpasnjëshme ne postin e Drejtuesit të Njesisë Bazë sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë";
- h. nuk kam mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015.
- i. nuk kandidoj për autoritete të tjera drejtuese në Universitetin e Arteve.

Kësaj kërkesë i bashkëngjitet:

- kopja e kartës së identitetit/pasaportës;
- kopja e noterizuar e titullit _____ që unë zotëroj;
- vërtetimi i qendrës time të punës;
- formulari i vetëdeklarimit për integritetin e lartë akademik.

Për sa kam deklaruar në këtë kërkesë, mbaj përgjegjësi penale dhe autorizoj organin përkatës të bëjë verifikimet që ai i konsideron të nevojshme.

Aplikuesi _____

U dorëzua më datën __/__/__, në sekretarinë e KZF